



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1178/1 Prot.

Tiranë, më 11 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 187 , datë 11 . 08 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 177 Regj., datë 05.08.2025, të shtetasit A. D, kundër Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës”, “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, ndër të tjera, pasqyrohet se:

Ankuesi nëpërmjet Urdhrit nr. 115, datë 06.04.2022 “Për fillimin e marrëdhënieve të punës”, me datë 06.04.2022, ka filluar marrëdhëniet e punës në detyrën “Magaznier”, pranë Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit.

Kjo marrëdhënie punësimi është formalizuar me datë 07.04.2022, përmes nënshkrimit të Kontratës Individuale të Punës, mes ankuesit si punëmarrës dhe Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, në cilësinë e punëdhënësit.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

Më datë 04.08.2022, pas rreth 4 (katër) muajsh punë, nëpërmjet Urdhrit nr. 229, datë 04.08.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH, ankuesit i është komunikuar si vijon:

“Ndërprerja e marrëdhënieve administrative dhe financiare me z. A. D, nga detyra “Magaznier” pranë Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, Reparti Ushtarak Nr. 6025, me Kod vendndodhje A-025, grupi B, paragrafi 03, numër rendor 005”.

Ankuesi shprehet se: *“Punëdhënësi duke vepruar si më sipër, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkak të justifikuar dhe, në një moment të papërshtatshëm, duke qenë se isha me raporte mjekësore, më ka ndërprerë marrëdhëniet e punës. Ndërkohë që unë punëdhënësin e kam njoftuar mbi ndërhyrjen kirurgjikale që do të bëja pranë QSUNT-së, me datë 14.07.2022, duke paraqitur dhe raportet mjekësore përkatëse, lidhur me justifikimin e mosparaqitjes sime në punë.*

Nisur nga sa më sipër, kam gjykuar se Urdhri i mësipërm për largimin tim nga puna është absolutisht i pavlefshëm, dhe për këtë arsye, me datë 27.12.2022 kam depozituar një kërkesë padi, e cila është regjistruar me datë 25.01.2023, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.”

Për sa më sipër, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të Vendimit nr. 2086, datë 09.04.2024, ndër të tjera, ka vendosur:

“Detyrimin e palës së paditur, ish punëdhënësit, Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, t’i paguajë paditësit A. D, si ish-punëmarrës:

- *2 (dy) paga mujore si dëmshpërblim për zgjidhjen në mënyrë të njëanshme, të menjëhershme dhe të pa justifikuar të kontratës individuale të punës;*
- *14 (katërmëdhjetë) ditë pagë mujore si shpërblim për mosrespektimin e afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës individuale të punës;*
- *2 (dy) paga mujore si shpërblim për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës individuale të punës...”*

Lidhur me largimin e tij nga puna, subjekti ankues pretendon se, ish-punëdhënësi e ka trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, duke e diskriminuar atë, pasi e ka larguar gjatë kohës që ishte me raporte mjekësore, për shkak të gjendjes shëndetësore që po kalonte.

Ankuesi shprehet se: *“ Urdhri që titullari ka ndërmarrë ndaj meje ka pasur si qëllim të krijonte idenë se unë nuk jam i aftë dhe i përshtatshëm për vendin e punës, si dhe krijimin e rrethanave e kushteve që të më largonte në një moment shumë të vështirë të jetës time, duke konsideruar vështirësitë shëndetësore në periudhën kur jam larguar nga puna.*

Të gjitha këto veprime diskriminuese karshi meje, janë në disproporcion me gjendjen time arsimore, me kualifikimet dhe eksperiencën në punë, shkaktojnë shëndetësore dhe për më tepër po t’i referohemi moshës time dhe vështirësisë për rigjetjen e punës. Gjatë procesit të hetimit administrativ mund të rezultojë edhe ndonjë shkak tjetër për të cilin nuk jam në dijeni.”

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri: *“Marrjen e masës përkatëse me gjobë ndaj Titullarit/Drejtorit të Përgjithshëm, z. R. H dhe Drejtorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, z. S. Z”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në analizën e deklarimeve të depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Sa i takon pretendimit të subjektit ankues se është diskriminuar përse i takon veprimeve të ndërmarra nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të të Menxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të DPRMSH-së kundrejt tij, lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, ato lidhen me periudhën kohore kur i janë komunikuar ankuesit dhe me momentin e njohjes me to.

Në këtë kontekst, subjekti ankues, lidhur me momentin kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar, shënjuar datën 04.08.2022, duke e lidhur atë me datën e largimit nga puna.

- Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, të gjitha pretendimet që burojnë nga veprimet e DPRMSH-së (apo strukturave e subjekteve të veçanta brenda saj), lidhen pazgjidhshmërisht me periudhën kur ato supozohet se kanë ndodhur ose marrë dënimin

(vitin 2022) dhe përsa i takon të drejtës së kundërshtimit të tyre, ndiqet e drejta e ankimit brenda afateve të caktuara ligjore.

- Subjekti ankues ka pohuar se është vënë në dijeni të veprimeve diskriminuese të pretenduara, nga ana e punëdhënësit, kundërt personit të tij, në datën 04.08.2022², kohë kur dhe i është njoftuar largimi nga detyra.
- Në kontekst të sa mësipër, subjekti ankues ka marrë dijeni lidhur me urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga ana e punëdhënësit, (*fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin*), dhe është njohur me aktet përkatëse, më datë 04.08.2022, kur i është komunikuar Urdhri me nr. 1039/1 prot., datë 04.08.2022, i Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH-së/punëdhënësit. Në rastin në fjalë, marrja dijeni dhe ndodhja e veprimeve diskriminuese të pretenduara, nëpërmjet aktit të largimit nga puna, kanë ndodhur në të njëjtën datë, pra më 04.08.2022.
- Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 05.08.2025, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni dhe më vonë se tre vite nga ndodhja e tij.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit A. D, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj³.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se LMD, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës”.

Nga ana tjetër, LMD, në nenin 36, pikat 1, 3, 4, të tij, parashikon se: “1.Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34⁴ të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.

.....

3.Gjykata e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim.

4.Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo

² Deklarim i ankuesit, si dhe bazuar në aktet bashkëlidhur ankesës. Si dhe cituar marrw dijeni nw tetor 2022.

³ Për analogji citojmë vendimin nr. 33, datë 07.02.2022, vendimin nr. 22, datë 19.01.2024, vendimin nr. 118, datë 12.05.2025, të KMD-së.

⁴ “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëshmipërbllim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”.

informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.”

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁵, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së z. A. D, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ Neni 36 i ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar: *“Procedura para gjykatës”*.